Latif Xhemaili

Sabit Rama

E DREJTA E AUTORIT

Qëllimi

Qëllimi i këtij shkrimi është ofrimi i një kontributi modest në shpjegimin e Veprës së Autorit si krijim i intelektit të personit fizik e në raste të caktuara edhe atij juridik, të Drejtën e lindur në bazë të këtij krijimi (E Drejta e Autorit), mbrojtjen e kësaj të drejte, me theks të veçantë në mbrojtjen e të drejtës autoriale në veprat audio vizuale, në mënyrë që opinionit e veçanërisht komunitetit të mediave tu vihen në disponim të dhëna sado qofshin ato modeste lidhur me këtë institut juridik.

AUTORI - është personi fizik i cili e ka krijuar veprën.
AUTOR - konsiderohet personi emri i të cilit, pseudonimi apo shenja e tij është theksuar në ekzemplarët e akteve ose veprave ose është shënuar apo theksuar në shfaqjen e veprës, derisa nuk provohet ndryshe. Përjashtimisht, personi fizik ose juridik emërtimi i të cilit ose emri theksohet në mënyrë të zakonshme në veprën filmike konsiderohet prodhues i asaj vepre, derisa nuk provohet ndryshe.

Përveç autorit, bartës i të drejtës së autorit mund të jetë edhe personi që nuk është autor, por që në përputhje me ligjin në fuqi, ka fituar të drejtën e autorit.

VEPRA E AUTORIT - është krijim origjinal i intelektit të autorit, e shprehur në një formë të caktuar, pavarësisht nga: vlera artistike, shkencore apo të tjera, destinimi i saj, madhësia, përmbajtja dhe mënyra e shprehjes, si dhe lejueshmëria e deklarimit publik.

TË DREJTAT E AUTORIT - përfshijnë të drejtat e bazuara në pronën intelektuale, të cilat u përkasin autorëve lidhur me punën e tyre në fushën letrare, shkencore dhe artistike.

E DREJTA E AUTORIT - është e drejtë e posaçme, e cila i takon autorit si subjekt i pronës intelektuale mbi veprën e vet.

Zhvillimi historik i të drejtës së autorit

Lindja e të drejtës së autorit është e lidhur ngushtë me lindjen e teknologjisë së shtypit si metodë e re e të shkruarit dhe kopjuarit, që për herë të parë u shfaq në Angli. Para se të fillonte të përdorej shtypi, për të kopjuar shkrimin përkatësisht punën e dikujt tjetër është dashur që të investohet shumë kohë dhe mund, kështu që nuk kishte arsye për ndonjë shqetësim të madh për kopjimet ilegale, apo si filloi të quhej më vonë, piraterinë, ngase kopjimet dhe shumëzimet e pa autorizuara ishin përjashtim i rrallë.

Teknologjia e shtypit, bëri një kthesë pozitive në sferën e të shkruarit duke krijuar lehtësi të mëdha, shkurtim të kohës e mundit dhe zvogëlim të shpenzimeve për të shkruar një libër apo një produkt tjetër. Mundësitë e mëdha të teknologjisë së shtypit, filluan ti keqpërdorin kopjuesit dhe tregtarët ilegal të veprave të ndryshme, të cilët filluan të përdorin metoda të reja më të avancuara të piraterisë, për të kopjuar e shumëzuar më lehtë, më shpejt dhe me çmim më të lirë, një libër apo një produkt tjetër, duke cenuar kështu të drejtat morale dhe ekonomike të autorit.

Me qëllim të parandalimit të piratërisë, shkruesit e librave, tipografët, libërlidhësit dhe shitësit e librave ne Angli u organizuan me një shoqatë qe njihet si "Shoqata e Librave".

Shoqata e Librave siguroi për veti monopolin për veprimtarin e botimeve, kurse shkrimtarët paguheshin vetëm për punën e tyre dhe nuk gëzonin asnjë të drejtë për krijimet e tyre. Ky monopol i "Shoqatës së librave" vazhdoi deri ne vitin 1709, kur Anglia aprovoj një akt ligjor, që njihet si Ligji i pare për të Drejtën e Autorit, sipas të cilit të drejtat ekskluzive për punën e tyre u takojnë autorëve e jo botuesve.

Edhe pse ky ligj ka shërbyer si model për të formësuar ligjet për të drejtat e autorit të shumë vendeve tjera, duke e vendosur autorin në qendër të mbrojtjes, sot ligjet për të drejtën e autorit hartohen për ti shërbyer edhe interesit të përgjithshëm publik.

KAPITULLI I

1. Çka është e drejta e autorit

E drejta e autorit, është termi i cili përfshin një grup të të drejtave të cilat iu njihen krijuesve për punën e tyre në krijimin e një vepre letrare, shkencore ose artistike. E drejta e autorit i takon autorit me vetë faktin e krijimit të veprës. Për të gëzuar mbrojtjen e së drejtës së autorit nuk kërkohet plotësim paraprak i çfarëdo formaliteti administrativ.

Autori gëzon të drejtat morale dhe ekonomike në lidhje me punën e tij nga çasti i krijimit të veprës që përfshijnë:

a. autorizimet ekskluzive personale për të mbrojtur pacenueshmërinë e veprës së autorit dhe personalitetin e autorit (në vijim: të drejtat morale të autorit),
b. autorizimet ekskluzive ekonomike për të mbrojtur interesat ekonomike të autorit (në vijim: të drejtat ekonomike të autorit),
c. autorizimet tjera të autorit (në vijim: të drejtat tjera të autorit).

Ky konglomerat i të drejtave ka qëllim për ta mbrojtur krijimtarinë e autorit nga përvetësimet, shfrytëzimet dhe abuzimet e ndryshme që mund ti kërcënohen veprës së autorit, në rend të parë për ruajtjen e origjinalitetit të krijimit pa përjashtuar edhe mbrojtjen e interesit ekonomik të autorit, që mund të shërbej si stimulim i kreativitetit të përgjithshëm, e me këtë edhe në vet zhvillimin e shoqërisë.

Thënë thjeshtë, e drejta e autorit shërben për ti baraspeshuar interesat e pronarëve të drejtës e autorit me interesat e përgjithshme me qëllim të avancimit në përparimin e shoqërisë.

2. Objekti i mbrojtjes i të drejtave të autorit

E drejta e autorit dhe lista e veprave përafërta te mbrojtura me te drejtën e autorit mund te ndryshoje nga shteti ne shtet varësisht nga kriteriumet që merren për bazë me rastin e përcaktimit të këtyre të drejtave. Për shembull Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk ofrojnë mbrojtje për veprat që nuk janë fiksuar në formë të prekshme (fizike).

Kryesisht, përmbledhja e veprave që mbrohen nga e Drejta e Autorit bëhet në bazë të kategorive përkatësisht zhanreve të caktuara p.sh. letrare,

muzikore,dramatike, kinematografike, kurse ligjet shtetërore përcaktojnë edhe ndarjen më specifike.

Ligji i Republikës së Kosovës Nr. 2004/45, për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Përafërta në nenin 1 të tij përcakton veprat për të cilat do t'iu ofrohet mbrojtje nga e Drejta e Autorit, duke i kategorizuar në:

- Të drejtat e autorit që, në bazë të pronës intelektuale, u takojnë autorëve përkitazi me
- veprat e tyre në lëmin e letërsisë, shkencës dhe artit (në vijim: e drejta e autorit);
- Të drejtat që, në bazë të pronës intelektuale, janë të afërta me të drejtën e autorit (në vijim: të drejtat e afërta) dhe u takojnë:

    a. interpretuesve përkitazi me interpretimet e tyre,
    b. prodhuesve të fonogrameve përkitazi me fonogramet e tyre,
    c. producentëve të filmit përkitazi me videogramet e tyre,
    d. organizatave të radios e të televizionit (Transmetuesve) përkitazi me emisionet e tyre,
    e. prodhuesve të bazave të të dhënave përkitazi me bazat e tyre të të dhënave,
    f. botuesve përkitazi me botimet e tyre.

I njëjti ligj nga neni 8. deri në nenin 11, në mënyrë taksative numëron verat autoriale të cilave do tu sigurohet mbrojtje juridike, kurse në nenin 12. përcakton krijimet pa mbrojtje juridike siç janë: idetë, parimet, udhëzimet, procedurat, zbulimet ose konceptet matematikore si të tilla, pastaj ligjet zyrtare, aktet nënligjore dhe rregullativat e tjera, materialet zyrtare dhe botimet e organeve parlamentare, qeveritare e të organizatave tjera që kryejnë funksione publike, si dhe parashtresat e aktet e tjera në procedurat administrative ose gjyqësore dhe lajmet e ditës me informacionet e ndryshme që kanë karakter të raportimeve të rëndomta të shtypit, radios e televizionit.

Megjithatë, kjo liste nuk duhet të merret si përfundimtare sepse veprat që janë përcaktuar në këtë ligj përbëjnë vetëm kategoritë themelore të veprave me të drejtë autoriale, me ç'rast mund të kërkohet mbrojtje e së drejtës së autorit edhe për veprat që nuk përfshihet në të, por i takojnë njërës prej kategorive të lartë përmendura.

Ligji i Kosovës për të Drejtën e Autorit ofron mbrojtje edhe për veprat e papublikuara, veprat e prejardhura, dhe koleksionet e veprave.

Veprat e papublikuara - do të gëzojë mbrojtje nga e drejta e autorit në mënyrën e njëjtë sikurse të ishte e botuar.

Veprat e prejardhura - nëse merret një vepër e krijuar nga dikush tjetër e që tash më ekziston dhe përkthehet nga gjuha origjinale ne gjuhen tuaj amtare, përkthimi konsiderohet si vepër e prejardhur dhe gëzon mbrojtje të së drejtës së autorit, kuptohet që përkthimi i veprës duhet të bëhet me autorizimin e autorit ndryshe konsiderohet si shkelje e te drejtës se autorit.

Vepra e prejardhur mund te jete edhe përshtatja, aranzhmani muzikor dhe përpunime tjera te një vepre ekzistuese ose material tjetër.

Parimet e zbatimit dhe mbrojtjes së të Drejtës Autoriale, lidhur me masat administrative, inspektimi, mbrojtja juridiko-civile dhe penale, të përcaktuara me, këtë ligj, zbatohen në përputhje me rregullat e përgjithshme të procedurës administrative, kundërvajtëse, civile dhe penale.

3. Kushtet për mbrojtjen e të drejtës s autorit

Duke marrë parasysh shembujt e lartpërmendur, autori gëzon mbrojtje juridike për të drejtat morale dhe ekonomike në lidhje me punën e tij nga çasti i krijimit të veprës. Nuk kërkohet regjistrimi apo plotësimi i kritereve të ndryshme për të siguruar të drejtën e autorit. P.sh. në bazë të ligjit të SHBA-ve vepra konsiderohet (e krijuar) prej momentit të fiksimit të saj ne formë të prekshme të shprehjes.

Në anën tjetër në baze të Ligjit të Kosovës vepra mbrohet prej momentit të krijimit dhe nuk ka nevojë të fiksohet në formë të prekshme të shprehjes. Neni 8 i Ligjit të Kosovës për të drejtën e Autorit thotë se veprat e mbrojtura nga e drejta e autorit janë vepra që shprehen në çdo mënyrë, thënë thjeshtë fiksimi nuk është kusht për gëzimin e mbrojtjes së të drejtës së autorit në bazë të Ligjit të Kosovës si është rasti në disa legjislacione tjera.

Për të gëzuar mbrojtjen të drejtës së autorit, secila prej veprave të lartpërmendura duhet të jetë origjinale. Por niveli i origjinalitetit që kërkohet dallon nga shteti në shtet, nga se disa shtete kërkojnë standard më të lartë të origjinalitetit, disa shtete tjera kërkojnë standard shumë më të ultë.

Në rastin gjyqësor Ladbroke Kundër William Hill (1964), gjykata ka shprehur se fjala origjinalitet nuk kërkon mendim origjinal ose shpikës, vetëm se vepra nuk është e kopjuar dhe vjen nga autori.

Konventa e Bernës dhe Marrëveshja TRIPS, len të lira shtetet që sipas vlerësimeve të veta të kanë të drejtë të trajtojnë çështjet e standardit për mbrojtjen e të drejtës së autorit. Mbi këtë bazë Ligji i Kosovës për të drejtën e autorit e përmend kërkesën e origjinalitetit në nenin 8, i cili përcakton veprat që mbrohen me të drejtën e autorit dhe kushtet për atë mbrojtje duke thënë se Vepra të autorit janë krijimet intelektuale origjinale ne lëmin e letërsisë, shkencës dhe artit.

Me termin origjinalitet lidhur me të drejtën e autorit, mund të kuptohen dy origjinalitete: ajo që është e lidhur me personalitetin e autorit-origjinaliteti i autorit dhe ajo që është e lidhur me rezultatet e krijimtarisë së autorit-origjinaliteti i veprës.[345]

Në legjislaturat kontinentale/evropiane, nuk është bërë harmonizimi i kërkesës për origjinalitetin. Përderisa Gjermania njihet për kritere të larta të kërkesës për origjinalitet, Anglia është njohur për kriter mjaft të ulta.

Një harmonizim më i avancuar është bërë vetëm për bazat e të dhënave, përmes Direktivave Evropiane për bazat e të dhënave, si dhe për fotografit përmes Direktivave tjera te Përafërta.

Pasi që Kosovës i mungojnë rastet nga praktika gjyqësore është vështir të thuhet se çfarë niveli të origjinalitetit kërkohet, por gjatë vlershmit të kërkesës për origjinalitet gjykata duhet të marr parasysh gjithmonë nivelin e kreativitetit të përdorur gjatë krijimit të veprës në fjalë. Idetë, udhëzimet, procedurat ose konceptet matematikore nuk mund të gëzojnë mbrojtje të së drejtës së autorit për shkak të mungesës së origjinalitetit. Ajo çka mbrohet me të drejtën e autorit është mënyra e shprehjes se këtyre ideve dhe fakteve. Gjykata duhet të kërkojnë nivele të caktuara të kreativitetit dhe origjinalitetit të përdorur gjatë shprehjes së këtyre fakteve ose ideve. Kjo mund të sqarohet më së miri përmes këtij shembulli.

Askush nuk mund të kërkojë të drejtën e autorit nëse thotë se "Barack Obama" është kryetari i 44 i SHBA-ve. Është fakt dhe secili e di këtë gjë.

[345] Prof.Dr.Abdullah Aliu, E drejta e Autorit, Prishtinë 2004 faqe 13.

Por nëse ndonjëri fillon të shkruaj ndonjë tregim për kryetarin Obama, atëherë ky tregim mbrohet me të drejtën e autorit sepse ai ka mbledhur të gjitha faktet, ka përdorur nivel të caktuar të kreativitetit personal në analizimin e këtyre fakteve dhe ka dalë me tregimin e vet të pavarur për kryetarin Obama.

4. Kohëzgjatja e mbrojtjes së të drejtës së autorit

Konventa e Bernës për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike dhe Konventa ndërkombëtare për mbrojtjen e interpretuesve, prodhuesve të Fonogrameve dhe subjekteve transmetuese, e njohur si Konventa e Romës, përcakton kohëzgjatjen minimale të mbrojtjes së të drejtave të cilat përcaktohen në to, duke u lënë Shteteve Kontraktuese lirinë e përcaktimit të kohëzgjatjes më të gjatë. Në bazë të konventës së Bernës kohëzgjatja minimale është jeta e autorit + 50 vite pas vdekjes se tij.346

Ekzistojnë dallime të shumta ndërmjet legjislacionit kombëtar që rregullojnë kohëzgjatjen e mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, dallime që nuk paraqiten vetëm ndërmjet kontinenteve, por edhe brenda vet Bashkimit Evropian. Gjithashtu ekzistojnë dallime edhe në mënyrën e llogaritjes së këtyre kohëzgjatjeve, kështu që me qëllim të lehtësimit të funksionit të tregut të brendshëm, Komisioni Evropian ka bërë hapa të caktuar për harmonizimin e legjislacioneve Kombëtare. Në këtë drejtim, Direktiva 2006/116/EC për kohëzgjatjen e mbrojtjes të drejtës së autorit dhe te drejtat tjera të përafërta e ka harmonizuar kohëzgjatjen e mbrojtjes së të drejtës së autorit në 70 vite pas vdekjes së autorit ose 70 vite pasi që vepra vihet në dispozicion të publikut në mënyrë të
ligjshme.

Ligji për mbrojtjen e të drejtës së autorit në Kosove, rregullon kohëzgjatjen e mbrojtjes dhe mënyrën e llogaritjes së kësaj kohëzgjatje në pajtim me direktivën e lartpërmendur, ashtu që e drejta e autorit zgjat tërë jetën dhe 70 vite pas vdekjes së tij (neni 62.1).

E drejta e autorit për vepra anonime dhe veprat e botuara me pseudonim zgjat 70 vite, dhe fillon nga momenti i hapjes se ligjshme te veprës (neni 62.2). Nëse autori e hap identitetin e tij gjatë kësaj periudhe, kohëzgjatja e mbrojtjes vlen për jetën e tij plus 70 vite pas vdekjes se tij.

---

[346] Konventa e Bernës per mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike 09.09.1886 neni 7.1.

E drejta e autorit ne veprën me bashkautorësi zgjat 70 vite gjatë jetës se secilit autori dhe 70 vite nga vdekja e bashkautorit që ka jetuar i fundit.

Ne rastet e veprave kolektive, e Drejta e Autorit zgjat 70 vite pas hapjes së ligjshme te veprës. Kur kohëzgjatja nuk fillon nga vdekja e autorit dhe vepra nuk është e hapur ligjërisht, e drejta e autorit zgjat 70 vite nga krijimi i tij.

Kur kohëzgjatja e mbrojtjes llogaritet nga dita e hapjes së ligjshme të veprës dhe vepra hapet në vëllime, pjesë-pjesë, vazhdimi, kohëzgjatja e mbrojtjes llogaritet ndaras për secilin nga këto elemente.

KAPITULLI II

1. Instrumentet kryesore ndërkombëtare dhe të BE-së për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta

Ligjet për të drejtën e autorit kanë natyrë territoriale që do të thotë se ato mund të dallojnë nga njëra tjetra varësisht prej shtetit. Disa shtete kanë kritere më të larta të mbrojtjes së të drejtave të autorit për disa vepra, kurse disa shtete tjera mund të preferojnë kritere më të ulta.

Për ti standardizuar këto dallime në shtetet e ndryshme, ndër vite janë miratuar instrumente të ndryshme ndërkombëtare. Në nivel të Evropës, ky harmonizim bëhet nëpërmjet direktivave të Komisionit Evropian.

Dokumentet/aktet më të rëndësishme ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtën e autorit janë:

1.1 Konventa e Bernës për mbrojtjen e veprave letrare dhe artistike (1886)

Konventa e Bernës është ndikuar shumë nga Ligji i Francës i cili autorin e veprës kreative e vë në qendër të mbrojtjes, në vend të rolit ekonomik të drejtës së autorit, i cili pasqyrohet me ligjin Amerikan. Në bazë të ligjit të Francës, autori i ka të drejtat natyrore në krijimin e tij sepse ai ka dhënë kontribut intelektual në atë vepër dhe për këtë arsye nuk ka nevojë për ligj që ti njihet kjo e drejtë.

Si rrjedhojë Konventa e Bernës ka hequr çdo formalitet për të drejtën e autorit për të gjitha shtetet që kanë aderuar në të. Me fjalë tjera, në bazë të

konventës së Bernës nuk ka nevojë të bëhet kërkesë për regjistrimin të drejtave të autorit por këtë të drejtë fitohet automatikisht që nga momenti i krijimit të veprës. Një gjë tjetër e cila është trajtuar dhe ndryshuar në Konventën e Bernës është edhe njohja ndërkombëtare e të drejtave të autorit. Para miratimit të konventës, personi që ka gëzuar të drejtën e autorit në shtetin A, ai nuk ka mundur të gëzoj të drejtën e autorit edhe në shtetin B dhe anasjelltas.

1.2 Konventa Universale të Drejtave të Autorit (1952)

Është miratuar ne Gjenevë dhe administrohet nga Organizata e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e kombeve të Bashkuara (UNESCO). Kjo Konvente ishte hartuar si Kompromis për ato shtete të cilat nuk dëshironin të bëhen pjesë e Konventës se Bernës për shkak të kushteve të përcaktuar në të. Shteteve qe kishin refuzuar ta nënshkruanin Konventën e Bernës ju ishte dhënë mundësia që prapë të jenë pjesë e një lloj marrëveshje ndërkombëtare. Edhe shtetet nënshkruese të konventës së Bernës gjithashtu u bën anëtare të UCC për të siguruar që veprat që janë krijuar në shtetet e Bernës të gëzon mbrojtje edhe në shtetet tjera që nuk ishin pjesë e Bernës.

1.3 Konventa e Romës për mbrojtjen e interpretuesve, prodhuesve të fonogrameve dhe organizatave transmetuese (1961)

Për dallim nga Konventa e Bernës e cila është traktat ndërkombëtar më gjithë përfshirës, Konventa e Romes është e kufizuar vetëm për interpretuesit, prodhuesit e fonogrameve dhe organizatat/subjektet transmetuese. Ajo administrohet bashkërisht nga WIPO, UNESCO, dhe ILO. Kjo Konventë mbron një interpretuesi (qoftë aktor këngëtar, muzikant kërcimtar etj.) me rastin e transmetimit i interpretimeve të drejtpërdrejta të tyre ose fiksimi i interpretimeve të drejtpërdrejta pa pëlqimin e tyre. Gjithashtu kjo konventë mbron edhe prodhuesit e fonogrameve dhe ju jep atyre të drejtën ekskluzive për të autorizuar ose ndaluar riprodhimin e fonogrameve të tyre në mënyrë të drejt ose tërthortë, sikurse që ju ofron mbrojtje edhe organizatave te transmetuesve duke iu dhen atyre të drejtën ekskluzive për të autorizuar ose ndaluar të drejtat e caktuara siç janë: ritransmetimi dhe fiksimi i programeve te tyre.

1.4 Marrëveshja TRIPS (1994)

Administrohet nga OBT-ja dhe përcakton disa standarde minimale të formave të ndryshme të pronës intelektuale. Ajo i detyron shtetet anëtarë të

saj të përfshijnë disa kërkesa në legjislacionin e tyre kombëtar sa i përket te drejtës së autorit, përfshirë të drejtat e interpretuesve, prodhuesve të fonogrameve dhe organizatave të transmetuesve.

Kërkesa kryesore sa i përket të drejtës së autorit janë:

- të drejtat e autorit duhen të jepen në mënyrë automatike pa formalitete siç janë sistemi i regjistrimit të mbrojtjes ose përsëritjes së saj,
- programet e kompjuterit duhet të trajtohen nga ligjet kombëtare për të drejtat e autorit si "vepra letrare" dhe ti kenë të njëjtat kushte të mbrojtjes,
- përjashtimet kombëtare nga e drejta e autorit(siç është shfrytëzimi i drejt) duhet të kufizohet nga testi tri-hapesh i Bernës,
- marrëveshja TRIPS gjithashtu njihet edhe për përcaktimin e procedurave të zbatimit, të mjeteve juridike dhe procedurat për zgjedhjen e kontesteve.

1.5 Traktati i së drejtës së autorit të WIPO (1996)

Mbron programet kompjuterike dhe i trajton ato si "vepra letrare". Në Bashkimin Evropian ky traktat zbatohet përmes direktivave të ndryshme të BE, siç janë: direktiva 91/250EC-e cila e cila krijon mbrojtjen e të drejtës së autorit për Softuer, direktiva 96/9/EC- për mbrojtjen e te drejtës se autorit për bazat e të dhënave dhe direktiva 2001/29/EC e cila ndalon pajisjet për shmangen e masave të mbrojtjes teknike siç është menaxhimi i të drejtave digjitale.

2. Direktivat më të rëndësishme të Bashkimit Europian

Direktiva 2001/29/EC për harmonizimin e aspekteve të caktuara të së drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta në shoqërinë informative apo siç njihet shkurt Direktiva Evropiane, e cila harmonizon ligjet kombëtare të shteteve anëtare të BE-së për mbrojtjen e të drejtës së autorit për të gjitha veprat e publikuara ne internet, telefon celular dhe pajisje digjitale.

Direktiva 2006/116/EC për harmonizimin e Kohëzgjatjes së Mbrojtjes së të drejtës së Autorit - harmonizon kohëzgjatjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta në të gjitha shtetet anëtare të BE-se. Kjo direktivë e ka zgjatur mbrojtjen të drejtës së autorit në 70 vite pas vdekjes së autorit, kurse

për të drejtat e përafërta, direktiva ofron 50 vite mbrojtje të këtyre të drejtave.

Direktiva 96/9/EC Parlamenti Evropian dhe Këshillit të datës 11 mars 1996 për mbrojtjen ligjore të bazës së të dhënave apo siç njihet shkurtimisht Direktiva e Bazës së të dhënave, është direktiva më kundërthënëse e Komisionit Evropian e cila ngrit shumë pikëpyetje për efikasitetin e saj. Kjo Direktivë ekskluzivisht e rregullon të drejtën e autorit për bazat e të dhënave dhe harmonizon mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave në tërë shtetet anëtare të BE-së.

Përveç mbrojtjes së të drejtës së autorit për mbledhjen dhe aranzhimin e të dhënave ose materialeve tjera, kjo konventë gjithashtu ofron edhe të ashtuquajturën mbrojtje "sui generis". Kjo mbrojtje, është formë tërësisht e re e të drejtës së pronësisë intelektuale e cila e zgjeron mbrojtjen jo vetëm në mbledhjen dhe aranzhimin e të dhënave ose materialeve të tyre (që mbrohen nga e drejta e autorit), por prodhuesit të bazës së të dhënave i jepet e drejta ekskluzive për të parandaluar nxjerrjen dhe shfrytëzimin e pa autorizuar të përmbajtjeve të bazës së të dhënave.

Kjo direktivë është kundërshtuar fuqishëm nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës e cila për dallim nga Evropa i ofron mbrojtje vetëm kreativitetit , i cili është shfrytëzuar në mbledhjen dhe sistematizimin e të dhënave ose informacioneve tjera, por jo edhe vet te dhënave ose informacionit.[347]

3. Ligji i Kosovës për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta dhe përputhja e tij me instrumentet ligjore ndërkombëtare dhe ato të BE-së

E drejta e autorit dhe të drejtat e përafërta në Kosovë rregullohen me Ligin për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta(Ligji Nr 2004/45), që është miratuar nga Kuvendi i Kosovës me datën 29 qershor 2006 dhe është shpallur me anë të rregullores së UNMIK-ut 2006/46 të datës 24 gusht 2006. Ky ligj i rregullon të drejtat që dalin nga e drejta e autorit dhe të drejtat e përafërta, administrimin e të drejtës së autorit dhe të drejtat e përafërta, si dhe mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtat e përafërta.

Në bazë të Ligjit për të Drejtën e Autorit dhe të drejtat e përafërta autori gëzon tri grupe të të drejtave: të drejtat ekonomike, të drejtat morale dhe

[347] Luljeta Plakolli-Kasumi, LL.M, Te drejtat e autorit dhe te drejtat e peraferta Moduli 1 fq.6

autorizimet tjera të autorit. Në pajtim me Konventën e Bernës dhe direktivat Evropiane, ligji nuk kërkon ndonjë formalitet për të drejtat e autorit, por kjo e drejtë i takon autorit nga vet fakti se ai është krijuesi i veprës.[348]

Neni 2 i Konventës së Bernës ia lë në diskrecion legjislacioneve vendore të vendeve të Bashkimit të vendosin nëse vlera nuk do të mbrohet po që se nuk janë fiksuar ne ndonjë formë materiale (fizike). Legjislacioni i Kosovës nuk përmban ndonjë kërkesë të tillë që do të thotë se një vepër nuk ka nevojë të fiksohet (shprehet) në formë materiale në mënyrë që të gëzoj mbrojtje. Në këtë drejtim, Ligji i ofron mbrojtje edhe veprave gojore si p.sh. fjalimet, leksionet, tregimet dhe veprat e ngjashme të shprehura gojarisht.

Neni 2-bis i Konventës së Bernës edhe në këtë rast ja lë legjislacionit kombëtar në diskrecion ti përjashtoj fjalimet politike dhe fjalimet e bëra gjatë procedurave gjyqësore nga kjo mbrojtje. Për dallim nga neni 2-bis i Konventës se Bernës, Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta përjashton materialin dhe publikimet zyrtare të parlamentit, qeveris dhe organizatave tjera që kanë kompetencë të zyrave publike por nuk thotë ndonjë gjë për fjalimet politike (Neni 12-c). Ligji është më se i qartë sa i përket fjalimeve të bëra gjatë procedurave gjyqësore, sepse neni 12 (e) thotë se parashtresat dhe aktet tjera administrative dhe procedurat gjyqësore nuk i nënshtrohen mbrojtjes së të drejtës së autorit.

Sa i përket të drejtave ekonomike, Ligji i Kosovës për të drejtën e autorit i jep autorit të drejtën për shfrytëzimin e veprave në formë lëndore, jo lëndore dhe të modifikuar. Në pajtim me nenin 14 të Konventës së Bernës, ndër të tjera ligji e jep edhe të drejtën e reproduktimit (riprodhimit) (Neni 22.2), kurse në pajtim me nenin 11 dhe 11-bis të Konventës së Bernës, Ligji jep të drejtën e interpretimit publik dhe komunikimit të performancës publikut, të drejtën e transmetimit (Neni 22.3) dhe në fund në pajtim me nenin 12 të Konventës së Bernës, përcakton të drejtën e përpunimit dhe përshtatjes të veprave audiovizuale.

Në pajtim me direktivën për Kohëzgjatjen e Mbrojtjes së të drejtës së Autorit, ligji mundëson mbrojtjen e të drejtës së autorit gjatë jetës plus 70 vite pas vdekjes së tij, përkundër Konventës së Bernës që mundëson mbrojtje gjatë jetës plus 50 vite pas vdekjes së autorit.

---

[348] Ligji për te drejtën e autorit dhe te drejtat e përafërta neni 6 dhe neni 7.

Ligji i Kosovës për drejtën e autorit përmban dispozita të posaçme për veprat e caktuara të mbrojtura me të drejtën e autorit siç janë veprat audiovizuale, programet kompjuterike veprat e krijuara gjatë marrëdhënies së punës dhe veprat e krijuara në shkollë. Në pajtim me Konventën e Romës, Marrëveshjen TRIPS, Traktatin e WIPO-s dhe Direktivat e KE-se, për interpretimet dhe Fonogramet, Ligji përmban dispozita të posaçme për të drejtat e interpretuesve, prodhuesve të Fonogrameve, producentëve të filmit, të drejtat e krijuesve të bazës së të dhënave dhe ato të botuesve.

Pjesa IV ligjit për të drejtën e autorit parasheh edhe menaxhimin dhe administrimin kolektiv të drejtave, por fatkeqësisht nuk ka sistem te shëndoshë te menaxhimit kolektiv e as ndonjë organ të qëndrueshëm administrativ i cili do të merret në mënyrë kompetente me këto çështje. Neni 169 i ligjit përcakton se Qeveria themelon Zyrën për Mbrojtjen e të Drejtave të pronës intelektuale brenda 18 muajve pas shpalljes së këtij ligji të shpallur në gusht të vitit 2006.

Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, në gjysmën e vitit 2010 ka ndërmarrë disa hapa për themelimin dhe funksionalizimin e kësaj zyre, por mund të thuhet se deri më tani pjesa e IV e këtij ligji mbetet efektive vetëm ne letër dhe se në këtë drejtim mbetet shumë për tu dëshiruar.

Nga konstatimi i më sipërm bënë përjashtim Komisioni i Pavarur për Media (KPM), i themeluar me Ligji Nr. 02/L-15 PËR KOMISIONIN E PAVARUR TË MEDIAVE DHE TRANSMETIMIN, e që është autoriteti i vetëm në territorin e Kosovës përgjegjës për menaxhimin, rregullimin dhe caktimin e resurseve të spektrit të frekuencave të transmetimit dhe për dhënien e licencave për shfrytëzimin e frekuencave transmetuese.

PM, bazuar në Ligjin Nr. 02/L-15 dhe në aktet nënligjore, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencimit e Kodin e Etikës për Mediat Elektronike, ka ngritur raste ligjore, duke shqiptuar sanksione në gjoba dhe të tjera, ndaj mediave elektronike, çdo herë kur përmes monitorimit të mediave ose në rast të ndonjë ankese është vërtetuar se ndonjëri medium ka bërë shkelje duke transmetuar ndonjë vepër filmike, program apo vepër tjetër, me të drejtë autoriale, pa siguruar paraprakisht marrëveshje të vlefshme për transmetim.

Sado që puna e cekur e KPM-së, ka dhënë rezultate konkrete në mbrojtjen administrative të të drejtës së autorit, funksionalizimi më i shpejtë i Zyrës për Mbrojtjen e të Drejtave të pronës intelektuale, në kuadër të Ministrisë së

Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe reformimi i mëtejmë i sistemit gjyqësor, ku një numër të konsiderueshëm të lëndëve do ta përbëjnë edhe rastet e menaxhimit dhe mbrojtjes së të drejtave të autorit, shteti i Kosovës do të bëjë edhe një hap më përpara drejt integrimeve Evropiane.